



URDHËR Nr. 291, datë 30.12.2022

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT
NR. 15, “PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE
EKONOMIKE” (SKK 15)**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 15 “Për kontabilitetin dhe raportimin financiar të mikronjësive ekonomike (SKK 15)”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

Delina Ibrahimaj

Botuar ne F.Zyrtare 13/2023

Dale nga shtypi me 24.01.2023

STANDARDI 15

PËR KONTABILITETIN DHE RAPORTIMIN FINANCIAR TË MIKRONJËSIVE EKONOMIKE I PËRMIRËSUAR (I ndryshuar)

Tiranë, Janar 2022 dhjetor 2022

KËRKESAT BAZË TË DETYRUESHME PËR MIKRONJËSITË

13. Pasqyrat financiare të shkurtuara përgatiten paraqiten dhe publikohen të paktën një herë në vit.

DATA DHE RREGULLAT E HYRJES NË ZBATIM TË KËTIJ STANDARDI

60. Ky standard me ndryshimet përkatëse do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhën kontabël, që fillon më ose pas datës 1 janar 2022. Ndryshimet e publikuara në prill 2022 ~~duhet~~ do të zbatohet zbatohen në mënyrë prospektive nga data 1 janar ~~2022~~2028, d.m.th pa ndryshuar pasqyrat financiare krahasuese të vitit ~~2021~~2027, të cilat janë përgatitur sipas kërkesave ekzistuese të kontabilitetit. Ndryshimet e publikuara në dhjetor 2022 do të zbatohen nga data 1 janar 2028. Lejohet zbatimi i mëhershëm i ndryshimeve të publikuara në prill 2022 dhe dhjetor 2022 duke e shpjeguar arsyen në shënimet shpjeguese.

Botuar ne F.Zyrtare 13/2023

Dale nga shtypi me 24.01.2023